



**PËRMBLEDHJE MBI INDIKATORË, TREGUES DHE
TIPOLOGJI PËR VEPRA PENALE TË LIDHURA ME
KORRUPSIONIN**

Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Metodologjia dhe qëllimi.....	4
3. Indikatorët e lidhur me korrupsionin.....	5
3.1 Indikatorë të lidhur me profilin e klientit.....	6
3.2 Indikatorë të lidhur me ndërveprimin dhe sjelljen e klientit.....	6
3.3 Indikatorët të lidhur me pasurinë ose të ardhura të pajustificuara.....	6
3.4 Indikatorët në lidhje me transfertat.....	8
3.5 Indikatorët të lidhur me aktivitetin e biznesit dhe prokurimet publike.....	8
3.6 Indikatorët në lidhje me përdorimin e mejeve virtuale dhe metodave alternative të pagesave.....	10
4. Tipologji vendase.....	11

1 Hyrje

Korrupsioni në përgjithësi mund të konsiderohet si abuzim i burimeve publike ose pushtetit publik për përfitime personale. Korrupsioni është një krim i përhapur që prek të gjitha vendet dhe ekonomitë. Përveç pengimit të rritjes ekonomike, korrupsioni ul besimin tek qeveritë, largon burimet e qeverisë nga iniciativat e rëndësishme dhe ndikon në ofrimin e shërbimeve jetike, si kujdesi shëndetësor, infrastruktura kombëtare dhe arsimi. Korrupsioni, si shumë krime, motivohet nga fitimi dhe për këtë arsye lidhet me pastrimin e parave, kështu që vendet me ekspozim të lartë ose cënueshmëri ndaj korrupsionit kanë një rrezik më të lartë ndaj pastrimit të parave.

Korrupsioni mund të ndodhë kudo: në biznes, në qeveri, në gjykata, në media dhe në shoqërinë civile, si dhe në të gjithë sektorët, nga shëndetësia dhe arsimi tek infrastruktura dhe sporti.

Korrupsioni mund të marrë shumë forma dhe mund të përfshijë:

- zyrtarët publikë që kërkojnë ose marrin para ose favore në këmbim të shërbimeve,
- politikanët që keqpërdorin paratë publike ose u japin punë publike ose kontrata sponsorëve, miqve dhe familjarëve të tyre,
- persona juridik që japin para zyrtarëve për të përfituar marrëveshje fitimprurëse.

Në raportin kombëtar kundër korrupsionit të vitit 2021¹ të përgatitur nga Autoritetet Shqiptare, ndër të tjera parashtrohet se janë ndërmarrë zhvillime strukturore të rëndësishme në drejtim të luftës kundër korrupsionit. Kapacitetet institucionale në luftën kundër korrupsionit janë fuqizuar përmes krijimit për herë të parë të Drejtorisë së Përgjithshme kundër Korrupsionit², përgjegjëse për vënien në jetë të politikave parandaluese, ndëshkuese e ndërgjegjësuere kundër korrupsionit dhe zgjerimit të Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit.

Kjo drejtori ka zhvilluar një sërë hetimesh administrative pranë institucioneve të ndryshme, pjesë të rrjetit kryesisht apo bazuar në ankesat dhe denoncimet e ardhura nga burime të ndryshme, ku sipas rastit në përfundim të hetimeve administrative të zhvilluara, janë propozuar në raportin përfundimtar marrja e masave administrative përkatëse kundrejt nëpunësve/punonjësve të këtyre institucioneve ose sipas rastit, janë paraqitur dhe kallëzime penale drejtuar/referuar organit të prokurorisë kompetente.

Një hap i rëndësishëm në këtë aspekt është edhe reforma në drejtësi e realizuar në vendin tonë. Institucionet ekzistuese janë modifikuar dhe janë krijuar institucione të reja me

¹ Raport-Vjetor-Kombëtar-për-Antikorrupsionin.

² Nëpërmjet vendimit Nr. 618, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave “për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”, të ndryshuar.

ndryshimet kushtetuese dhe ligjet organike specifike. Ndër këto institucione janë Prokuroria e Posaçme, e cila ushtron veprimtarinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Gjithashtu, është krijuar edhe Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) si një strukturë e specializuar e policisë gjyqësore që heton veprat penale në juridiksionin penal të Prokurorisë së Posaçme, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, në zbatim të ligjit 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar.

Përmes reformave rregullatore në fushën e auditimit, krijimit të sistemit të prokurimit elektronik me qëllim rritjen e transparencës në fushën e prokurimeve publike, u shënua rritje e performancës së qeverisë në këto fusha, çka evidentohet edhe nga treguesit e përbërë të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare. Po dhe ngritja e sistemeve të e-Tatimeve, e-Doganave dhe e-Albania³ ka lehtësuar ndjeshëm procedurat administrative përkatëse dhe ka reduktuar kontaktet personale të përdoruesve/kërkuesve të shërbimit me administratën, si dhe ka kontribuar në uljen e nivelit të korrupsionit në këta sektorë.

Zhvillimi kyç në lidhje me masat parandaluese dhe politikën kundër korrupsionit, ka qenë shtrirja e strategjisë aktuale kombëtare kundër korrupsionit në vitin 2023⁴ dhe zhvillimi i strategjisë së re kundër korrupsionit. Disa nga objektivat kryesore të strategjisë përfshijnë rritjen e transparencës, forcimin e përgjegjshmërisë, mekanizmave të integritetit dhe përmirësimin e praktikave të sinjalizimit. Një tjetër zhvillim i rëndësishëm, ka qenë digjitalizimi i deklaratës së pasurisë të personave që kanë detyrim për deklaram në bazë të kuadrit ligjor dhe themelimi i Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit në vitin 2021⁵.

2 Metodologjia dhe qëllimi

Ky dokument është hartuar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) dhe konsultuar me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me qëllim paraqitjen në mënyrë të përmbledhur të indikatorëve, treguesve dhe tipologjive (kombëtare dhe ndërkombëtare) të lidhura me veprat penale në korrupsionit. Për realizimin

³ Portal qeveritar ku shërbimet publike që gjenden në zyrat dhe sportelet fizike të institucioneve ofrohen në mënyrë elektronike falë Platformës.

⁴https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/1.-PLANI-I-VEPRIMITANTIKORRUPSION-2020-2023_AL.pdf.

⁵ **Rrjeti i Koordinatorëve kundër Korrupsionit**, ri konceptuar nga pikëpamja e organizimit dhe funksionimit me Vendimin Nr. 618, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave “për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”, të ndryshuar, drejtohet nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit dhe përbëhet nga Koordinatorët e emëruar në institucionet pjesë e Rrjetit dhe struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë.

e kësaj përmbledhje jemi mbështetur në analizimin e rasteve të trajtuara nga AIF⁶, si dhe në raporte ndërkombëtare⁷ apo njësi homologe të tjera⁸.

Ky dokument ka për qëllim të identifikojë një sërë treguesish apo indikatorësh, metodash, dhe tipologjish, që mund të përdoren në kuadër të detektimit, raportimit të rasteve potenciale të korrupsionit dhe ndihmës/orientues në mbikëqyrëse. Gjithashtu, ky dokument ka për qëllim të ndihmojë organet ligjzbatuese, të inteligjencës dhe subjektet raportuese, për njohje më të mirë të indikatorëve dhe tipologjive që lidhen me korrupsionin.

Njohja dhe përdorimi i indikatorëve, treguesve dhe tipologjive, vjen në ndihmë të subjekteve raportuese për një sërë arsyes si:

- Identifikimin e modeleve, sjelljeve të korrupsionit në mënyrë sa më të efektshme;
- Raportimin e rasteve të dyshimta sa më cilësore duke ndihmuar në forcimin e sistemit të parandalimit të pastrimit të parave;
- Monitorimin e transaksioneve nëpërmjet integritetit të indikatorëve në sistemet e monitorimit që kanë në përdorim;
- Zhvillimin e një profili sa më gjithëpërfshirës të riskut të klientit;

Gjithashtu vjen në ndihmë edhe të organeve ligjzbatuese, të inteligjencës duke marrë në konsideratë se indikatorët, tipologjitë e parashtruara mund të jenë tregues se diçka e pazakontë po ndodh kur nuk kemi një shpjegim të arsyeshëm, duke përmirësuar analizën dhe investigimin financiar.

Indikatorët nuk përbëjnë një listë shteruese duke marrë parasysh, ndër të tjera, evoluimin e vazhdueshëm të procedurave për kryerjen e transaksioneve dhe mund të përdoren në kuadër të detektimit, raportimit, analizimit të rasteve potencialisht të dyshimta.

3 Indikatorët e lidhur me korrupsionin

Indikatorët e korrupsionit mund të kategorizohen në disa mënyra si të lidhura me profilin e klientëve, sjelljen e klientëve, natyrën e transaksioneve dhe modelin e aktivitetit ekonomik. Më poshtë janë paraqitur disa indikatorëve sipas kategorive kryesore.

⁶ Këto raste dhe të tjera gjenden të publikuara edhe në Raportet Vjetore, në faqen web të institucionit tonë.

⁷ Public Summary FIU TOOLS AND PRACTICES FOR INVESTIGATING LAUNDERING OF THE PROCEEDS OF CORRUPTION nga EGMONT GROUP.

Set of Indicators for Corruption Related Cases nga EGMONT GROUP.

⁸ INDICATORS OF CORRUPTION AND CASE ANALYSIS 2021 nga Latvijas Republikas prokuratūra.

3.1 Indikatorë të lidhur me profilin e klientit

- Lidhje familjare ose biznesi me persona të përfshirë në afëra korrupsioni ose vet klienti ka precedentë penalë të mëparshëm të lidhur me korrupsion/shpërdorim detyre;
- Anëtarët e afërt të familjes ose personat të lidhur me PEP, emërohen si zyrtarë të lartë drejtues në persona juridik privat në dukje, pa plotësuar kërkesat e nevojshme për marrjen e pozicionit ose paga e të punësuarit nuk është në përpjesëtim me kushtet e tregut;
- PEP rrisin nivelin e tyre të jetesës në mënyrë të pajustificuar pas përfundimit të mandatit të tyre, nisur nga natyra e transaksioneve/investimeve që kryejnë;
- Klienti rezulton i lidhur me persona juridik të regjistruar në vende me lehtësira fiskale ose kompani guaskë (shell companies);
- Klienti si person juridik ka një strukturë të paqartë pronësie, ku pronarët përfitues fshihen/nuk identifikohet dot lehtë për shkak të përdorimit të struktura komplekse të pronësisë.

3.2 Indikatorë të lidhur me ndërveprimin dhe sjelljen e klientit

- Klienti refuzon për të dhënë informacion të detajuar mbi burimin e të ardhurave duke ndikuar në mungesë transparence mbi origjinën e fondeve;
- Hezitimi apo ngurimi për të dhënë detaje ose shpjegime të besueshme për krijimin e një marrëdhënie biznesi, hapjen e një llogarie bankare ose kryerjen e transaksioneve;
- Klienti jep deklarata kontradiktore mbi burimin e pasurisë ose fondeve;
- Përdorimi i persona të tretë (familjarë ose jo) për të kryer transaksione në emrin e një PEP;
- Kërkesa për realizimin në një kohë të shkurtër dhe urgjente të veprimeve financiare si p.sh shlyerja parakohe e një kredie, hipoteke ose transaksioni blerje.

3.3 Indikatorët të lidhur me pasurinë ose të ardhura të pajustificuara

- Ndryshime të papritura në pasurinë e klientit që nuk kanë burim të qartë të të ardhurave;
- Depozitime të mëdha ose të përsëritura pa një burim të qartë ligjor;
- Transaksione të mëdha nga ose drejt PEP ose personave të lidhur me të;
- Blerje të pasurive të paluajtshme me shuma që nuk përputhen me të ardhurat e deklaruara;
- Blerje e pasurive të paluajtshme me para në dorë, pa kredi nga institucione financiare ose financim të ligjshëm të njohur;
- Blerje dhe rishitje e shpejtë e një prone me një çmim më të lartë pa arsye të dukshme ekonomike;
- Copëzimi e depozitimeve në transaksione të vogla për të shmangur pragjet ligjore të raportimit;
- Transaksione të shpeshta në cash që nuk janë të zakonshme për profilin e klientit;

- Pagesa për shlyerjen e një kredie nëpërmjet pagesave (cash apo transferta) në vlera të larta;
- Përdorimi i llogarive të familjarëve apo personave të lidhur me PEP për të qarkulluar fonde në mënyrë të paqartë;
- Një PEP investon apo është i përfshirë në forma të ndryshme të produkteve financiare jashtë vendit si: depozita bankare në shtete të tjera, investime në portofole të jashtme (aksione, obligacione, fonde investimi), kuota në kompani të huaja etj;
- Përfitimi i depozitimeve të shumta në cash në monedha të ndryshme, në llogaritë e një PEP, nga palë të treta në një kohë të shkurtër;
- Mbajtja dhe përdorimi i llogarive të shumta bankare pa një qëllim të qartë ekonomik;
- Përdorimi i fondeve trust si një mekanizëm për të transferuar, fshehur ose menaxhuar pasuritë e PEP në mënyrë që të shmangë monitorimin financiar dhe detyrimet ligjore;
- Depozitime në cash nga PEP ose palët e lidhura me ta, e ndjekur nga tërheqja e fondeve nga llogari të hapura në vende me risk të lartë;
- Tërheqje të mëdha në cash duke përdorur çeqe në emër të PEP ose në emër të palëve të treta të lidhur me PEP;
- Fonde të dërguara nga persona juridik guaskë në llogari të individëve, personave juridikë ose marrëveshjeve juridike pa lidhje të dukshme me PEP, por që dihet se kontrollohen prej tyre;
- Përfaqësuesi i një PEP (d.m.th. avokat, sekretar, kontabilist) hap llogari dhe investon në prona të shtrenjta ose mallra luksoze;
- Përdorimi i personave “fasadë” që zakonisht janë persona të lidhur me PEP si p.sh shoferi, financier, për të fshehur përfituesin real të pasurisë duke përfshirë punonjës të PEP. Fondet e përfituara në llogaritë e këtyre personave zakonisht tejkalojnë të ardhurat e tyre të deklaruar;
- Përfitimi nga PEP të shumave të mëdha jo proporcionale me pagesat në treg për të njëjtin shërbim për pjesëmarrje në workshop, konferencë ose si këshillues projektsh;
- Mospërputhje ndërmjet burimit të deklaruar të pasurisë së një PEP dhe deklaratave të tyre të pasurive të plotësuara gjatë ushtrimit të funksionit;
- Blerja ose dhënia me qera e pasurive të luajtshme nga PEP apo familjarë të tyre, të cilat nuk përkojnë me të ardhurat e tyre;
- Përfitimi i interesave nga një PEP në përfundim të periudhës së maturimit të depotizës me afat të një personi fizik që mund të jetë e lidhur me një PEP ose një palë të tretë;
- Të ardhura në cash ose me transfertë nga burime të ndryshme në llogarinë e një PEP të cilat shpenzohen më pas në lojra fati online – kreditimi nga faqe të njëjta ose të ndryshme të lojrave të fatit;
- Pagesa nga OJF (me të cilat dihet që PEP ka lidhje) si "honorare", “shpenzime konsulence” ose “paga” për PEP ose të afërmit e tij ose pagesa të tërthorta për shpenzime personale të PEP, si pagesa për arsimimin e fëmijëve, blerje pronash, udhëtime luksoze, etj.;

- Përdorimi i shtetasve të huaj të cilët njihen si lobbyistë, konsulentë ndërkombëtarë, apo ndërmjetës financiarë për të kryer transaksione në vende ku ata nuk kanë lidhje të qarta;
- Burimi i deklaruar i pasurisë së fondeve të marra në llogarinë e një PEP nuk përputhet me historikun e deklaruar të karrierës, eksperiencës ose moshën e klientit;
- Blerje të mëdha të aseteve të luksit (p.sh. makina, vepra arti, ora të shtrenjta) me para në dorë.

3.4 Indikatorët në lidhje me transfertat

- Transferime të papritura drejt llogarive bankare në juridiksione që përcëjnë risk për pastrim parash;
- Përfitimi i transfertave të shumta ndërkombëtare nga dërgues të ndryshëm në një kohë të shkurtër ose në të njëjtën ditë;
- Përfitimi i transfertave ndërkombëtare në llogarinë e lojtrave të fatit e cila pasohet nga tërheqje të menjëhershme;
- Transferime fondesh nga ose drejt personave juridik guaskë ose të sapo krijuara pa një historik financiar;
- Transferimi i menjëhershëm i fondeve nga llogaria e një personi juridik në llogarinë personale të një PEP dhe kalimi i mëposhtëm i fondeve në llogarinë e një pale të tretë;
- Transferta në mbërritje nga shtete të huaja (veçanërisht nga shtete të klasifikuara si me risk të lartë) në llogaritë e PEP, që janë të destinuara për blerjen e pasurive të paluajtshme, të luajtshme ose blerjen e mallrave të luksit, që zakonisht nuk përmbajnë informacione shtesë rreth transaksionit dhe informacioni i nevojshëm është i paqartë.
- Transferimi i fondeve nga llogaritë e PEP në persona juridik trust ose që kanë në strukturën e tyre truste në vende me risk të lartë;
- Përfshirja e PEP në transferta të fondeve publike në llogari të lidhura me të ose të afërm të tij, shpesh duke justifikuar pagesat si shpenzime qeveritare.

3.5 Indikatorët të lidhur me aktivitetin e biznesit dhe prokurimet publike

- Dërgime ose marrje fondesh nga kompani pa ndonjë aktivitet të dukshëm;
- Pagesa të bëra për kontrata publike, por pa dokumenta të shërbimeve të ofruara;
- Persona juridik që rregullisht ndryshojnë pronësinë para ose pas marrjes së kontratave publike;
- Persona juridik me kapital të vogël, nënshkruajnë kontrata me vlera të larta;
- Në llogarinë e personit juridik qarkullojnë shuma të mëdha parash, por pa dokumentacion të qartë financiar;

- Rritje e papritur e qarkullimit të një personi juridik pa ndonjë zgjerim të dukshëm të aktivitetit;
- Përzierja e transaksioneve personale me ato të personit juridik duke krijuar vështirësi për ndarjen e tyre;
- Persona juridik që paguajnë persona të tjerë juridik për të kryer punimet logjistike në vende që kanë një nivel të lartë të korrupsionit për shërbime të cilat mund të kryhen vetë nga kompania;
- Personat juridik që ndryshojnë termat e marrëveshjes dhe definicionet e ndërmjetësve për të shmangur regjistrimin dhe aspektin rregullator në vende të tjera;
- Personat juridik përfitojnë tendera publikë të cilat hapen për një periudhë të shkurtër kohore;
- Personi juridik që përfiton kontrata publike ose përfaqësues të tij rezultojnë në informacionet mediatike si të lidhur me korrupsionin ose krime të tjera financiare;
- PEP përfitojnë ose blejnë kuota: në një person juridik ku blerja është e financuar nga shitësi; në një person juridik ku çmimi i blerjes është më i ulët se vlera neto e aseteve të kompanisë; dhe përfiton dividend i cili është në disproporcion nga çmimi i blerjes;
- PEP krijojnë persona juridikë ose marrëveshje juridike, të cilat më pas investojnë në pasuri të paluajtshme me vlerë të konsiderueshme pa një burim të qartë për të justifikuar këto fonde;
- Kontratat afatgjata i jepen në mënyrë të përsëritur të njëjtit nënkontraktor ose një personi juridik të caktuar ose marrëveshje ligjore, që në mënyrë të vazhdueshme fiton pjesën më të madhe të tenderave/ofertave të prokurimeve publike;
- Krijimi i personave juridik fiktiv nga ana e palëve të lidhura me PEP për të fituar një kontratë të prokurimeve publike dhe pas përfundimit të saj mbyllja e tyre;
- Lëshimi i specifikimeve të paarsyeshme për zbatimin e kontratës (përfshirë kushtet kufizuese për vendndodhjen e kontraktorit, kushte kufizuese për materialet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, veçanërisht afate të ngushta, etj.) nga autoriteti prokurues;
- Nënkontraktorët kanë drejtor(ët), pronar(ët) përfitues dhe/ose janë të lidhur me menaxhimin e kontraktorit;
- Nënkontraktorët/ndërmejtësuesit hyjnë në një marrëveshje biznesi pasi një kontratë është nënshkruar tashmë pa një qëllim të dukshëm;
- Kontraktorët, nënkontraktorët ose bashkëpunëtorët e tyre (brenda afatit për plotësimin e kontratës shtetërore) kanë të njëjtën adresë, numër telefoni, IP adresë, etj;
- Projektet e prokurimit janë të investuara nëpërmjet një marrëveshje kredie nga organet shtetërore por çmimi i tenderit është dukshëm më i lartë sesa kredia e kërkuar;
- Depozitimet në llogaritë e PEP me çeqe të lëshuara nga personat juridik në fushën e ndërtimit, individë ose persona juridik jo qeveritare që më parë kanë përfituar kontrata nga prokurimet publike;
- Personat juridik me eksperiencë të vogël ose të kufizuar në marrjen e kontratave/projekteve qeveritare shumë komplekse dhe teknike (që nuk përputhet me

madhësinë ose eksperiencën e tij) ose përfitimi i kontratave/projekteve qeveritare që nuk janë të lidhura me fushën e tyre të aktivitetit;

- Një person juridik ose marrëveshje e caktuar, që është kontraktues i një personi juridik tjetër të zotëruar nga shteti, përfiton zakonisht pagesa në vlera të larta për të mira ose shërbime që normalisht duhet të kushtojnë më pak (kur krahasohet me çmimin e tregut);
- Fondet e përfituara nga një kontraktor i prokurimeve publike nuk janë shpenzuar në një afat kohor të caktuar për të plotësuar detyrimet kontraktuale;
- Pala kontraktuese lëshon karta bankare tregtare për individët që nuk janë punonjësit e tij dhe përdoren për blerje të mallrave të luksit, pagesa për shërbime të shtrenjta ose transaksione të tjera që nuk janë në përputhje me aktivitetin e biznesit;
- Pagesat në bazë të kontratës së prokurimit publik kryhen me çmim më të lartë sesa ishte kontrata fillestare;
- Pagesat e kryera sipas kontratave të prokurimit publik ku ka pasur vetëm një ofertë për një tender prokurimi qeveritar, gjë që sinjalizon mungesë konkurrence dhe akses të mbyllur;
- Komisionet, interesat ose pagesat sipas kushteve komerciale të kontratës së prokurimit publik rriten, pakësohen ose ristrukturohen në një mënyrë që nuk është komercialisht e zbatueshme.
- Blerja e të mirave sipas kontratave të prokurimeve pa dërgimin e mallrave të tilla në territorin doganor të vendit;
- Pagesat janë të lidhura me llogaritë e ofruesve të mallrave, punës dhe shërbimeve, të cilët operojnë në shtete të ndryshme nga origjina e mallrave, puna dhe shërbimet.

3.6 Indikatorët në lidhje me përdorimin e mejeve virtuale dhe metodave alternative të pagesave

- Depozitime të vlerave të larta jo në përputhje me të ardhurat e tyre të deklaruara në portofolë financiarë të panjohur jashtë vendit;
- Transferime të vlerave të larta jo në përputhje me të ardhurat e tyre të deklaruara në portofolë financiarë të panjohur jashtë vendit;
- Transferime në më shumë se një platformë elektronike/virtuale për të shpërndarë fondet;
- Përfitimi i vlerave nga platforma të parasë virtuale dhe kalimi në llogari bankare;
- Klienti transferon kriptovaluta në një adresë të lidhur me shërbimet e miksimit (mixer/tumbler);
- Fondet hyjnë në llogari nga adresa të panjohura dhe dalin menjëherë pa një model të qartë të përdorimit;
- Shitja e koleksioneve dixhitale për çmime të fryra për të justifikuar pasuritë e pajustificuara;
- Përdorimi i një numri të madh kartash të parapaguara me vlera të larta;

- Përdorimi i kartave të parapaguara për të bërë transaksione ndërkombëtare në vende të njohura për rrezikun e pastrimit të parave.

4 Tipologji vendase

Tipologji 1: Burim i dyshimtë i të ardhurave dhe investime në vlera të konsiderueshme në pasuri të paluajtshme⁹

Shtetasi G në vitin 2018 ka lidhur kontratë për blerje të një pasurie të paluajtshme në vlerë prej 130,000 EUR. Kjo vlerë investimi ka shërbyer si shkak për të investiguar më tej lidhur me burimin e të ardhurave të shtetasit G, i cili ushtron detyrën e një funksionari publik.

Nga verifikimet e kryera rezultoi se:

- Familjarët e këtij shtetasi kanë kryer dy investime të tjera në pasuri të paluajtshme dhe sende luksi, përsëri në vlera të konsiderueshme në total 205,000 EUR,
- Në emër të shtetasit G është regjistruar një person juridik, por fitimet nga ky aktivitet rezultuan të jenë të papërfillshme krahasuar me investimet e kryera prej tij dhe familjarëve të tij,
- Nga verifikimet për transaksionet bankare të kryera prej tij rezulton se shtetasi G ka kryer veprime bankare të shtrira në kohë në shuma të larta, ku spikasin veprimet me para në dorë,
- Përveç kontratës së sipërcituar ai rezulton të ketë lidhur edhe 6 kontrata noteriale, ndër të cilat evidentohen investime të tjera në pasuri të paluajtshme. Vërehen edhe 3 kontrata huaje të lidhura prej tij sipas të cilave ka marrë hua nga disa persona (shtetasi P) dhe anëtarë të familjes së tij, të cilat përdoren edhe si justifikim për burimin e fondeve, por këta persona nuk kanë kapacitet ekonomik për gjenerimin e fondeve të tilla.

Verifikimet e kryera për shtetasin P dhe familjarët treguan se nuk rezultojnë të dhëna bankare të cilat mbështetnin huadhëniet ndaj shtetasit G. Nga informacioni për shtetasin G, rezulton të ketë nisur një proces penal ndaj tij për veprën penale ‘shpërdorim detyre’.

Në konkludim të analizës, duke marrë në konsideratë se shtetasi G:

- Ka kryer investimet të shpeshta e në vlera të larta në pasuri të paluajtshme,
- Ka kryer investime në sende luksi në vlera të larta,
- Ka lidhur disa kontrata (vërehet lidhja e më shumë se një kontrate brenda të njëjtës datë),
- Rezulton të ketë marrë hua shuma të konsiderueshme prej anëtarëve të një familje, duke i deklaruar këto fonde si burimin e investimeve të tij.

Informacioni është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

⁹ Tipologjia 3 marrë nga Raporti Vjetor 2018 i AIF.

Tipologji 2: Dyshime për skemë të pastrimit të parave nga një PEP¹⁰

Shtetasi A, bashkëshort i shtetases B, ish-PEP në pozicion të lartë drejtues në një institucion publik X, rezultonte të kishte nënshkruar disa kontrata noteriale huaje, në cilësinë e palës huamarrëse me qëllim jo të qartë për sa i përket marrjes dhe përdorimit. Si huadhënës, shfaqeshin shtetas të njohur për AIF, si të përfshirë në dyshime për pastrim parash. Nisur nga sa më sipër u kryen verifikime të mëtejshme nga ku rezultoi se shtetasi A, kishte regjistruar një person juridik, që ushtronte veprimtari në fushën e ndërmjetësimit, e emërtuar “DX”. Shoqëria “DX” më tej lidh një kontratë huaje nëpërmjet së cilës do t’i huazonte vlerën prej 40,000 EUR një shoqërie tjetër “EX”, e cila do të kryente një pagesë në favor të një institucioni publik për një leje të miratuar në favor të shoqërisë. Verifikime të mëtejshme treguan se leja e miratuar, lidhej drejtpërdrejtë me interesat pasurore të shtetasit A. Më tej, shtetasi A, bleu shumicën e kuotave të shoqërisë “EX” (të cilës i kishte dhënë hua, nëpërmjet shoqërisë “DX”), në vlerë 1 milion EUR, duke përforcuar dyshimet për krijimin e një skeme me qëllim humbjen e gjurmëve lidhur me përfituesit fundor të lejes, mënyrës së grumbullimit të fondeve dhe arsyet e huadhënies në favor të një personi juridik, të cilit i mungonte eksperiencia e duhur në sipërmarrjen e iniciuar rishtazi.

Bazuar në:

- Krijimin e një veprimtarie ekonomike në një fushë që nuk përputhej me profilin e mëparshëm të individit;
- Investimi në një shoqëri të dytë, e cila më herët kishte përfituar nga një leje e dhënë nga një Ent Publik;
- Origjina e huazuar e fondeve nga subjekte me profil të dyshimtë dhe përdorimi për investimet në aktivitetin e biznesit;
- Lidhja familjare me një ish-PEP.

U krijua dyshimi se kishim të bënim me një skemë të pastrimit të parave dhe informacioni është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

Tipologji 3: Hua dhe sponsorizime të dyshimta nga një PEP¹¹

Në gusht 2021, shtetasi A me profil biznesmen, i dha hua shumën 70.000 USD një funksionari shtetëror shtetasit B, i cili e ka garantuar shlyerjen e huasë me hipotekimin e një pasurie të paluajtshme të llojit truall në pronësi të tij. Në burime të hapura informacioni ka të dhëna se shtetasi A është arrestuar disa vite më parë i akuzuar për vepra penale në fushën fiskale. Gjithashtu u konstatua një lidhje indirekte (konflikt interesi) ndërmjet objektit të

¹⁰ Tipologjia 4 marrë nga Raporti Vjetor 2020 i AIF.

¹¹ Tipologjia 3 marrë nga Raporti Vjetor 2021 i AIF.

veprimtarisë së personit juridik të shtetasit A dhe fushës së veprimtarisë së institucionit ku ushtron detyrën shtetasi B. Në shtator 2021, shtetasi B i ka tërhequr cash fondet e marra hua (70.000 USD) nga llogaria e tij bankare dhe ia ka dhënë cash (dorazi) një të afërmit të tij pensionist, shtetasit X në formë mbështetje financiare.

Ky i fundit, brenda të njëjtës ditë i ka depozituar fondet në llogarinë bankare të një shoqërie ndërtimi me të cilën disa muaj më parë, shtetasi X kishte lidhur një kontratë porosie me qëllim blerjen e një njësie tregtare në Tiranë. Vlera e kontratës është 150.000 USD dhe palët kanë rënë dakord që pagesa e vlerës totale të pasurisë të bëhej me këste.

Bazuar në dyshimet:

- Natyra e paqartë e huasë së marrë me qëllim investimin në pasuri të paluajtshme nga persona të tretë të lidhur me PEP;
- Lidhjen e paqartë mes palëve të përfshira në këto transaksione, rasti është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

Tipologji 4: Këmbimi i pasurive dhe përdorimi i dyshimtë i kredive¹²

Në vitin 2021 shtetasja A (bashkëjetuese e shtetasit B) dhe shtetasi B (ish PEP) kanë lidhur një kontratë noteriale me një kompani ndërtimi për shkëmbim të 2 pasurive të paluajtshme të llojit apartament në emër të përbashkët të tyre me një vilë në një kompleks ndërtimor në një zonë të njohur rezidenciale. Apartamentet (sipërfaqe totale prej 130 m²) me të cilat u këmbyen ndodheshin në një zonë periferike të blera dy vite më parë ndërsa shtetasi B ishte ende në detyrë. Vlera e deklaruar e blerjes së tyre ishte 80,000 GBP, ku 80% e shumës e financuar me kredi bankare dhe pjesa tjetër nga kursimet. Pas blerjes apartamentet u rivlerësuan me vlerë tregu 110.000 GBP. Në kuadër të këtij shkëmbimi pasurish midis shtetasve A, B dhe shoqërisë së ndërtimit ishte rënë dakord që do të paguhej vlera shtesë prej 120.000 GBP, e cila do të mbulohej me marrjen e një kredie bankare me kësht mujor 1.000 GBP. Ndërkohë vila e përfituar nga këmbimi me një sipërfaqe 350 m² u vendos kolateral në funksion të marrjes së kredisë së re dhe u vlerësua sipas çmimit të tregut 400.000 GBP. Nga verifikimet e kryera mbi burimin e fondeve të tyre, u vunë re rënie të ardhurave personale dhe të aktivitetit tregtar të bashkëjetueses së shtetasit B.

Bazuar në dyshimet:

- Përfitimi nëpërmjet këmbimit të një pasurie të paluajtshme nën çmimin real të tregut;
- Përdorimi e instrumentit të kredisë e njohur edhe si tipologji në rastet investimeve nga PEP/ish PEP me qëllim mbulimin e burimit real të fondeve;
- Mos justifikimi i pagesave të kësteve të larta të kredisë, nga burime të ligjshme të deklaruar prej tyre.

Rasti u dërgua për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

¹² Tipologjia 7 marrë nga Raporti Vjetor 2021 i AIF.

Tipologji 5: Investim në vlerë të lartë në pasuri të paluajtshme në mënyrë jo të drejtpërdrejt¹³

Shtetasja X e moshës 80 vjeç në cilësinë e palës blerëse ka nënshkruar, një kontratë për blerje pasurie të paluajtshme në vlerën 2.000.000 EUR. Nga verifikimet e kryera shtetasja X rezultoi të ishte e afërmja e shtetasit Y-ish funksionar i lartë publik (PEP). Në lidhje me mënyrën e pagesës rezultoi se, çmimi total i blerjes do të mbulohej nga shoqëria ‘DX’ e cila nga ana e saj për pagimin e kësaj vlere, kishte marrë kredi pranë bankës ‘AEF’. Në marrëveshjen midis palëve, pas shlyerjes së plotë të detyrimit, shtetasja X do të kryente më tej procedurat për kalimin e pronësisë në favor të shoqërisë ‘DX’. Nga verifikime të mëtejshme të kryera rezultoi se ortak në shoqërinë ‘DX’ ishte një shtetas i quajtur F, për të cilin rezultonte i regjistruar një procedim penal, si dhe indicie negative në burimet e hapura për veprimtari kriminale. Indiciet e administruara nga burimet e hapura, tregonin për lidhje midis shtetasit F dhe ish-funksionarit Y, përforcuar dhe nga një kontratë huaje e lidhur paraprakisht përmes dy shoqërive (shoqëria ‘EX’ e shtetasit F dhe shoqëria ‘LM’ të shtetasit Y) të zotëruara prej tyre.

Bazuar në dyshimet:

- Investimin në pasuri të paluajtshme, në vlera të larta të pajustificuara;
 - Përfshirja e personave me precedentë kriminalë;
 - Përdorimi i personave të tretë si shtetases X, e afërme e një PEP;
- rasti u dërgua për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

Tipologji 6: Transaksione të dyshimta nga persona juridik në fushën e mjekësisë¹⁴

Shtetasi X djali i shtetasit Y ish PEP, në vitin 2016 ka themeluar në një nga vendet e rajonit shoqërinë “Alpha” me objekt veprimtarie: “Tregti e pajisjeve”. Që në ditët e para të themelimit shoqëria “Alpha” lidhi një kontratë me objekt “Shitjen e pajisjeve” në vlerën 2.000.000 USD me Laboratorin Mjekësor “AB” që operonte në të njëjtin shtet me shoqërinë “Alpha”. Në marrëveshje midis palëve u ra dakord që pagesa të kryhej me këste duke aplikuar normë interesi dhe duke bërë që vlera totale që duhej paguar nga Laboratori Mjekësor “AB” kundrejt shoqërisë “Alpha” të ishte 4.000.000 USD, pra 2 fish i vlerës së pajisjeve. Gjatë një periudhe kohore prej 6 vitesh shoqëria “Alpha” ka përfituar në kuadër të kësaj kontrate, nëpërmjet transfertave të shumta mujore të gjithë shumën 4.000.000 USD.

Vlera e përfituar është përdorur për transfertat drejt:

- kompanisë “Alpha-S” e regjistruar po në të njëjtin vend si shoqëria “Alpha” dhe me ortak shtetasin Z
- llogarisë personale të shtetasit X në Shqipëri me përshkrim ‘dhënie huaje’ apo ‘kalim dividendi’,

¹³ Tipologjia 8 marrë nga Raporti Vjetor 2021 i AIF.

¹⁴ Tipologjia 9 marrë nga Raporti Vjetor 2021 i AIF.

- pagesa për udhëtime;
- pagesa faturash në vlera të ulta për persona juridik të ndryshëm në vendin tone.

Nga verifikimet rezulton se shoqëria “Alpha”, nuk ka kryer asnjë import për pajisjet e shituara dhe nga librat e shitblerjes rezulton që produktet të jenë blerë në vlerë totale 2.000.000 USD nga dy personat juridik si më poshtë:

- Shoqëria “AT” e cila ka patur bashkëpunim të mëparshëm me Laboratorin Mjekësor “AB” (paguar sipas faturave 1.500.000 USD);
- Shoqëria “Alpha-S”, ortaku i të cilës shtetasi Z ka pasur bashkëpunime të mëparshme me Laboratorin Mjekësor “AB”.

Bazuar në faktin se një personi juridik pa eksperiencë në fushën përkatëse, në pronësi të afërmit të ish PEP, blen pajisje nga dy shoqëri furnitore për t’ia shitur më pas një personi juridik tjetër me çmim dy herë më të lartë, ndërkohë që pajisjet mund të bliheshin drejtpërdrejt nga ky i fundit, lindën dyshime se këto transaksione kanë për qëllim mbulimin e fondeve të dyshimta të gjeneruara në Shqipëri, për rrjedhojë informacioni është dërguar për investigim të mëtejshëm në organet ligj zbatuese.

Tipologji 7: Investime në pasuri nga PEP me vlerë të deklaruar nën çmim tregu¹⁵

Shtetasja X ka ushtruar detyrën si PEP në fushën e drejtësisë për një periudhë të gjatë kohore. Në lidhje me këtë shtetase nga burime të hapura rezultonin të dhëna për veprimtari të mundshme korruptive gjatë ushtrimit të detyrës.

Nga ana jonë u kryen verifikime të mëtejshme në lidhje me të dhe familjarët e saj nga sa rezultoi se:

- Shtetasja X për një periudhë të gjatë kohe rreth 12 vjet, nuk e tërhiqte apo përdorte për shpenzime pagën e saj, të përfituar nga pozicioni si PEP por e investonte atë në depozitë me afat duke akumuluar rreth 130.000 EUR;
- Kjo shtetase në llogari të saj personale kishte kryer depozitime cash në vlera që variojnë nga 3.000 EUR deri në 30.000 EUR, të deklaruar si të ardhurave nga biznesi familjar;
- Bashkëshorti e saj rezultoi me pagë minimale si i vetëpunësuar pranë biznesit familjar ndërsa fëmijët ishin përfshirë në marrëdhënie punësimi vetëm vitet e fundit.

Gjithashtu bashkëshorti i shtetases X, gjatë këtyre viteve kishte kryer investime në disa pasuri të paluajtshme (sipërfaqe toke) të blera fillimisht me vlerë të ulët krahasuar me çmimin e tregut për të lidhur më pas kontrata sipërmarrje për kryerjen e ndërtimeve rezidenciale, nga e cila do të përfitonin 50% të sipërfaqes së ndërtimit.

Nga verifikimi për personat juridik të deklaruar rezultoi se bashkëshorti i saj kishte regjistruar dy persona juridik të llojit ‘Person fizik’, në të cilat herë pas here kryheshin investime/rregullime të për zgjerim aktiviteti. Për personat juridik janë deklaruar fitime

¹⁵ Tipologjia 10 marrë nga Raporti Vjetor 2021 i AIF.

vjetore në vlera që variojnë nga 400.000 LEK deri në 2.000.000 LEK. Në llogaritë e këtyre personave juridik nuk ka qarkullime fondesh të tilla për të justifikuar aktivitetin e tyre.

Bazuar në dyshimet:

- Depozitat e krijuara nga mos përdorimi ndër vite i pagës,
 - Depozitimet e pajustificuara me para në dorë në llogari personale;
 - Investimet e kryera në sipërfaqe toke me vlerë të ulët, me qëllim dhënien e tyre për ndërtim, skemë kjo e njohur në fushën e pastrimit të parave;
- rasti u dërgua për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

Tipologji 8: Depozitime nga një PEP i huaj¹⁶

Shtetasja e huaj A nga një vend Europian, në vitin 2020 ka kryer depozitime në vlerën 250 000 USD në llogarinë e saj bankare pranë një banke të nivelit të dytë në vend. Nga verifikimet e kryera rezultoi se shtetasja A, ishte PEP i huaj dhe fondet janë transportuar fizikisht duke deklaruar në hyrje të Pikës Kalimit Kufitar në Shqipëri, si fonde nga kursime familjare. Gati një vit më pas, shtetasja A transferon shumicën e fondeve në favor të një shoqërie ndërtimi në vendin tonë, me qëllim porosinë e një pasurie të paluajtshme të llojit “vilë” në një qytet bregdetar, kundrejt një çmimi blerjeje të njëjtë me shumën e depozituar prej saj.

Nga verifikimet e mëtejshme pranë homologëve tanë, rezultoi se shtetasja A deri në muajt e parë të vitit 2021 ka ushtruar një funksion të lartë shtetëror, në vendin e saj të origjinës dhe është nën hetim për akuzat e pastrimit të parave dhe rryshfetit. Shtetasja A, e ka vizituar disa herë vendin tonë, edhe në pozicionin e funksionarit, përpara se të vendoste të investonte në pasuri të paluajtshme.

U vu re se depozitimet në vendin tonë përkojnë në vlerë dhe periudhë me fondet për të cilat shtetasja është nën akuzë nga vendi i huaj.

Bazuar në dyshimet:

- Hetimet e vendit të huaj për akuzat e pastrimit të parave dhe rryshfetit;
 - Depozitime në para fizike në vlerë të konsiderueshme nga një person i ekspozuar;
 - Burimi jo bindës i fondeve të depozituara cash dhe të investuara,
- rasti u dërgua për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

Tipologji 9: Dyshime për veprimtari të lidhura me korrupsionin¹⁷

Shtetasja B, në periudhën 2019-2023, ka qenë përfaqësuese ligjore e disa shtetasve, në proceset gjyqësore me object dëmshpërblimet e dëmeve pasurore dhe jo pasurore.

¹⁶ Tipologjia 3 marë nga Raporti Vjetor 2022 i AIF.

¹⁷ Tipologjia 6 marë nga Raporti Vjetor 2023 i AIF.

Këto procese gjyqësore janë zhvilluar gjithmonë në dy qytete (M, L), fakt i cili fillimisht dukej rastësi. Me analizimin e mëtejshëm të të dhënave, rezultoi se palët paditëse me qëllim ngritjen e padisë, ndryshonin vendbanimin e tyre.

Nga të dhënat e disponuara rezultoi se shtetasja B ka lidhje familjare me shtetasin F, me funksion public public në sistemin gjyqësor.

Mes shtetasës B dhe palëve paditëse janë lidhur marrëshjet përkatëse sipas të cilave fondeve e përfituara nga dëmshpërblimi do transferoheshin në llogarinë bankare të shtetasës B, panë bankave X, Y, Z. Të gjitha veprimet procedurale dhe gjyqësore kryheshin nga përfaqësuesja e palëve paditëse shtetasja B.

Nga analizimi i llogarive bankare të shtetasës B, vihet re se pas kreditimit të fondeve, vijohet me tërheqjen e tyre, me deklarin "dhënien e tyre përfituesve". Shjegimi i dhënë për këto tërheqje lidhet me një zgjidhje personale të shtetasve përfitues, për të qëndruar jashtë sistemit banker, për arsye pasigurie.

Totali i tërheqjeve arrin 3 milion EUR.

Nga të dhënat e disponuara linden dyshime të arsyeshme se shtetasit përfitues të fondeve mund të kishin shpeshherë dijeni për shumën reale të përfiturar.

Për sa më sipër duke marre në konsideratë:

- Vlerat e larta të tërhequra, të përfituara për dëmshpërblimin e palëve të treat, për të cilat ka dyshime për mënyrën e përdorimit të tyre;
- Ndryshimet fictive të vendbanimit të palëve paditëse;
- Kanalizimi i këtyre çështjeve gjyqësore nga përfaqësuesja ligjore, të lidhura me dëmshpërblim, vetëm në dy institucione gjyqësore;

Rasti u dërgua për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

Referencat:¹⁸

- [Specific Risk Factors in the Laundering of Proceeds of Corruption.pdf.coredownload.pdf](#);
- [INDICATORS OF CORRUPTION AND CASE ANALYSIS.pdf](#)
- [20190710-Public-Summary-FIU-Tools-and-Practices.pdf](#)
- [Corruption-red-flags-final-version-20181030.pdf](#)

¹⁸ Materialet e përdorur: Raportet Vjetore të AIF, Specific Risk Factors in Laundering the Proceeds of Corruption, *Burimi*: FATF Report; INDICATORS OF CORRUPTION AND CASE ANALYSIS 2021, *Burimi*: FIU Latvia; Public Summary FIU TOOLS AND PRACTICES FOR INVESTIGATING LAUNDERING OF THE PROCEEDS OF CORRUPTION 2019, *Burimi*: EGMONT GROUP; Set of Indicators for Corruption Related Cases, *Burimi*: EGMONT GROUP.